



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 400/01-11968/24
26.06.2024
Dragash - Dragaš

Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për
Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027

Qershor, 2024

Hyrje

Planifikimi i buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2025, bazuar në planifikimet e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 është 12,872,214 euro. Në kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2025 janë paraparë 4,714,448 euro, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve 5,844,424 euro, mallra dhe shërbime 1,513,342 euro, subvencione dhe transfere 400,000.00 euro, si dhe shpenzime komunale 400,000.00 euro. Në kuadër të buxhetit të paraparë për vitin 2025, pjesa më e madhe e planifikimit të të hyrave janë nga Granti Qeveritar (5,185,780 euro), Granti Specifik për Arsimin (3,705,015 euro), Granti Specifik për Shëndetësinë (1,480,765 euro), si dhe të hyrat vetanake (551,054 euro).

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të 11 shtatorit 2008, si dhe Nenit 31 të UA (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Qarkoren Buxhetore 2025/01 të Ministrisë së Financave, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, në koordinim me kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, në bashkëpunim edhe me zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive komunale, Grupin Punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës, si dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027.

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takim direkt të mbajtur në lokalitet).

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, me datë 10.02.2023 kryetari i Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, ka nënshkruar Vendimin për formimin e grupit punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore për projekt-buxhetin e Komunës së Dragashit për vitin 2024. Me qëllim të zgjerimit të anëtarëve në Grupin Punues, me datë 16.06.2023 ka plotësuar Vendimin paraprak të Grupit Punues, nga tre (3) sa ishin paraparë me vendimin e parë, në nëntë (9) anëtarë: Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Lindita Kozmaqi Piraj – ZBGJ, Arben Skenderi – zyrtar financiar nga Drejtoria e Shëndetësisë, Bean Hadziasan – drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Ambientit, Nuhia Tairovci – Drejtoria për Shërbime Publike, Fari Kolloni – Zyra për Informim, Burim Aliu – Zyrtar Kryesor Financiar, Uzair Hamza – shef i Zyrës për Komunitete, si dhe Kaltrina Krasniqi – zyrtare për Buxhet në Drejtorinë e Arsimit. I njëjti Grup Punues ka vazhduar punën edhe në organizimin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027.

Procesit të hartimit të Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 i ka paraprirë Qarkorja Buxhetore 2025/01 e Ministrisë së Financave. Në kuadër të dëgjimeve buxhetore të mbajtura nga data 13.06.2024 deri më datën 18.06.2024, është diskutuar dhe prezantuar Draft Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027. Në këtë proces, Zyra për Informim ka qenë e angazhuar në përpilimin e procesverbaleve të cilat janë publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit.

Në suaza të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, ku si i tillë është përcjellë edhe me ftesat publike dhe informimi në kohë për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore. Ftesat dhe informatat për organizimin e dëgjimeve buxhetore janë publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës (Shqip: <https://kjarke.gov.net/dragash/category/takimet-dhe-degjimet-publike-buxhetore-njottimet-takimet-dhe-degjimet-publike-buxhetore/>); Boshnjakisht: <https://kjarke.gov.net/dragash/sr/category/sastanaei-i-jayne-budzetske-rasprave-obavestenja/>) si dhe në mekanizma tjerë alternativë, të tilla si rrjeti social Facebook (<https://www.facebook.com/profile.php?id=100066575766996>).

Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, Komuna e Dragashit ka synuar që dokumentet e projeksioneve buxhetore të jenë në konsultim edhe përmes formave elektronike, duke u dhënë mundësi qytetarëve të kenë qasje në këto dokumente.

Për më tepër, Qarkorja Buxhetore 2025/01 dhe Draft KAB-i 2025-2027 janë publikuar në uebfaqen e Komunës. (Qarkorja 01: https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/05/Qarkorja-Buxhetore-2025-01_Final.pdf ; Draft KAB-i 2025-2027: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/KAB-2025-2027.docx>).

Njoftimet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë janë publikuar brenda afateve ligjore në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Facebook. Në fund të secilit njoftim janë publikuar emailat e zyrtarëve ku qytetarët kanë pasur mundësi t'i dërgojnë kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Njoftimet janë publikuar në gjuhët zyrtare. Çdo vonesë eventuale në publikimin e njoftimeve për dëgjimet buxhetore në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit ka qenë për shkak të problemeve me funksionimin e uebfaqes.

Njoftimet e publikuara në uebfaqen e Komunës:

Shqip:

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/05/Kalendar-i-degjimeve-buxhetore-1.pdf>

2. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me OJQ, biznese dhe fermerë:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/06/Njoftimi-1-Scan-1.pdf>

3. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/06/Njoftimi-2.pdf>

4. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me qytetarë, gra, vajza, pensionistë, të rinj dhe komunitete joshumicë:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/06/Njoftimi-3-2.pdf>

Boshnjakisht:

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/05/Kalendar-i-degjimeve-buxhetore-2.pdf>

Njoftimet e publikuara në faqen zyrtare në Facebook të Komunës së Dragashit:

Shqip:

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://www.facebook.com/share/p/1N6Zc1K1eN1U3dJL/>

Boshnjakisht:

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://www.facebook.com/share/p/2U5AC1D7YKUs76ak/>

Grupi Punues, në kuadër të ndarjes së përgjegjësisë dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik për projekt-buxhetin e Komunës, kishte planifikuar shfytëzimin e databazës së konsultimeve publike për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe përfshirjen së tyre në proces të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, Grupi Punues përmes Zyrës për Informim, përmes komunikimeve elektronike ka dërguar ftesa të personalizuar për grupe të ndryshme qytetare, përfshirë: OJQ, biznese, përfaqësues të organizatave rinore etj.

Bazuar në Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues në koordinim me ekzekutivin e Komunës ka planifikuar të mbajë 3 dëgjime buxhetore, nga data 13 qershor deri më 18 qershor 2025. Në të gjitha dëgjimet buxhetore ka marrë pjesë dhe ka prezantuar para qytetarëve drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim. Ndërkaq, në dy dëgjime buxhetore ka marrë pjesë dhe ka kryesuar takimin kryetari i Komunës, ndërsa një dëgjim buxhetor është kryesuar nga nënkryetari i Komunës.

Tabela me të dhënat e përgjithshme

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Asamblesë Komunale, me OJQ, biznese dhe fermerë	13.06.2024, 1 orë	33 pjesëmarrës	1 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Asamblesë Komunale, me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë	14.06.2024, 1 orë	41 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Asamblesë Komunale, me qytetarë, gra, vajza, pensionistë, të rinj dhe komunitete joshumicë	18.06.2024, 1 orë	22 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Publikimi në uebfaqe / platforma elektronike	15 ditë	0 pjesëmarrës	0 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike (të drejtpërdrejta) si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa tabela e detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Draft Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më **30 qershor 2024** do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Dragashit.

	<p>3. Propozoj që zona e Pishave, në bashkëpunim me AKP-në të zgjidhet problemi i pronës dhe të bëhet një park me infrastrukturë përcjellëse dhe parking për veturat. Të bëhen staza për ecje dhe shëtitore;</p>		<p>Pranohet pjesërisht</p>	<p>Për fat të keq, kjo zonë është pronë e Pylltarisë dhe Komuna nuk mund të ndërhyjë pa lejen e saj. Megjithatë, Komuna do të bëjë përpjekje që të ndërmerret diçka në këtë drejtim, sepse kjo ide për ndërtimin e një parku në atë zonë është një ide shumë e mirë.</p>
--	--	--	----------------------------	--

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rrks.gov.net/dragash/news/komuna-e-dragashit-nilloi-degjimet-buxhetore-ne-qytetare-per-kab-2025-2027/>

Boshnjakisht: <https://kk.rrks.gov.net/dragash/sr/news/budzetska-sadusanna-za-gradjanima-za-srednjavocnu-budzetski-okvir-nibt-2025-2027-pocela-si-dragas/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: https://www.facebook.com/share/p/1hDy9UQr4e8YfPU_m/

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1Ca8VLeNGY6PZoW7/>

Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për KAB 2025-2027	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
1.	<p>1. Para dy viteve është ndarë një buxhet për investimet kapitale, për sanimin e banjove të nxënësve, ku është krye ajo, mirëpo kanë mbetur në gjysmë të punës dy kabinetet ku është filluar puna dhe nuk punohet aty. Deshta të di a është regjistruar diçka nga investimet kapitale për këtë pjesë;</p>	<p>Shukri Nebiu - drejtor i ShML "Ruzhdi Berisha"</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Do të shikohet se ku qëndron problemi dhe ku ka ngecur puna, për këtë pjesë do të bisedojmë edhe me DKA-në. Problemin e mjeteve financiare nuk e kemi, kemi fond të mjaftueshëm dhe besojmë se kjo kërkesë do të realizohet.</p>
2.	<p>1. A keni pa ndonjë mundësi për me funksionalizue shkollë profesionale në Dragash? Nëse ajo shkollë nuk i plotëson kriteret për shkollë të mesme apo për shkak të largësisë, çka mundet me u bo për me iu ndryshue destinacioni. U bënë dhjetë vite e më tepër dhe ajo nuk është funksionale. Ai objekt mundet me krye punë për shumë sende tjera dhe me i pru të ardhura Komunës së Dragashit;</p>	<p>Jeton Qengaj - OJQ "Avoko"</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Sa i përket objektit të shkollës profesionale në fshatin Shajne, ajo shkollë që nga fillimi ka pasur probleme për shkak se nuk është e pranuar teknikisht. E kemi regjistruar si pronë në emër të Komunës dhe e paguajmë personelin për mbikëqyrjen e saj. Aktualisht jemi duke e shfrytëzuar për aktivitete të ndryshme publike, siç është organizimi i Panairit "EXPO SHARRI" etj.</p>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks.gov.net/dragash/news/sot-u-mbajt-degjimi-buxhetor-per-kab-in-me-punetoret-e-arsimit-dhe-shendetesis/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks.gov.net/dragash/sr/news/danas-je-odrzana-budzetska-rasprava-so-direktorima-skola-predavacima-prosvjetnim-radnicima-i-zdravstvenim-radnicima/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/DFmR24ZB9wEz39C8/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/55D2DyMYRYS71vWH/>

Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me qytetarë, gra, vajza, pensionistë, të rinj dhe komunitete joshumicë

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për KAB 2025-2027	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Fshati ynë, i cili është njëri nga të paktët që ende nuk ka një stadium, është i njohur për sukseset e vazhdueshme në sport. Në emër të të rinjve të fshatit, kërkoj që të bëhet ndërtimi i një stadiumi në fshatin Kosavë;	Senat Trupaj - banor i fshatit Kosavë	Pranohet	Kërkesa e rinisë së fshatit Kosavë është me vend. Mirë që e keni bërë kërkesën edhe me shkrim, duhet t'i bashkëngjitet vetëm edhe sigurimi i lokacionit, a ka vend ku të ndërtohet. Kur është fjala për kërkesat e rinisë, ne jemi në gjendje dhe jemi të disponimit që këto kërkesa t'i çojmë në vend edhe t'i realizojmë.

2.	<p>1. Prezantohet sot komunitetin e fshatit Zgatar. Edhe herën e kaluar ky komunitet ka kërkuar që të bëjë rrethimin e varrezave të reja të fshatit Zgatar. Nuk e di a është marrë në shqyrtim apo jo. Andaj, si kërkesë primare e komunitetit është rrethimi i varrezave të reja të fshatit;</p>	<p>Sabahat Hasani – banor i fshatit Zgatar</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Deri në shtator kemi mundësi që të bëjmë ndryshime në buxhet. Përveç mjeteve që i kemi paraparë për kubëzime, për mure mbrojtëse, ne kemi shtuar edhe mjete të tjera, kështu që ka mundësi që ato mjete që i kemi shtue, t'i orientojmë në rrethimin e varrezave të fshatit Zgatar.</p>
3.	<p>1. Komunën e Dragashit e kanë lënë mbrapa, duke mos pas mundësi linjat e autobusit për me ardhë. Nëse ne bashkarisht e ndërmarrim për vitin tjetër një buxhet, t'i subvencionojmë disa linja të autobusit për me i pru në Dragash – vetëm në ora 08:00 e kemi një linjë, e për Prizren i kemi 20 linja – nëse ne e ndajmë një buxhet dhe i biem për Dragash dy-tri linja, më besoni që do ta ngjallim Dragashin;</p> <p>2. Pastaj, është shumë kënaqësi me i pa mbjelljen e lulave në Komunë të Dragashit. Nuk e di ajo kompani që i ka mbjellë, a e ka për mirëmbajtjen dhe</p>	<p>Jeton Qengaj – banor i Dragashit</p>	<p>Pranohet pjesërisht</p>	<p>Çështja e linjës së autobusëve i përket edhe nivelit qendror, gjithashtu edhe bizneseve private. Ne si Komunë do të bëjmë përpjekje që t'i kryejmë obligimet tona, në mënyrë që ta shtyjmë përpara këtë kërkesë.</p>

<p>ujitjen. Nëse nuk e ka ujitjen, atëherë duhet të caktohet një përgjegjës. Nëse s'keni mundësi ju me e caktue një përgjegjës, unë e marr përsipër, dal vetë i ujiti. Po vetëm me u mbjellë lula dhe me u lënë me atë gjendje, nuk është e pranueshme, sepse ato po thahen;</p> <p>3. Pastaj është edhe një problem tjetër: Nuk jam kundër këtyre trafikave që janë në Dragash, është shumë mirë me krijue vende të punës, bile edhe me i subvencionue – po të paktën ta bëjmë një kriter, t'ia përshtatim një vendi turistik dhe t'i bëjmë ato trafikate me dru, e ta rregullojmë pak, se me të vërtet qendra e Dragashit, nganjëherë kur hyjmë në Dragash na doket vetja shumë katastrofale;</p> <p>4. Pastaj, është një problem te stadioni i Graniçarit, me u rregullue infrastruktura, e kemi edhe një pjesë të malit, pjesë të brendshme shumë të mirë që duhet</p>		<p>Pranohet</p>	<p>Sa i përket stazës për ecje, ne e kemi në projekt, kemi konkurruar në MAPL me projekt. Sipas informatave që i kemi marrë nga niveli qendror, projekti ka kaluar. Gjithashtu, edhe ne mjete të Komunës kemi të ndara,</p>
--	--	-----------------	---

	të bëhet me staza të ecjes. Jo me kubëzim, të jetë natyral, po vetëm vendosja e dritave aty do të ishte shumë një kënaqësi, se në mbrëmje ka shumë njerëz që shkojnë dhe e vizitojnë;			sepse këto projekte bëhen me bashkëfinancim. Po ashtu, gjatë përgatitjes së KAB-it, ne i kemi ndarë edhe 185 mijë eur, mjete për përfundimin e stadiumit të qytetit, këtu përfshihet edhe infrastruktura, edhe ndriçimi i pjesës ku to të bëhet staza e ecjes, çuarja e rrymës deri te stadiumi, edhe ndërtimi i tribinave.
4.	1. Unë si shef i Zyrës për Komunitete, kam nevojë të theksoj se ndarja e buxhetit është bërë edhe për komunitetet në Komunën tonë. Dua të them pse përfaqësohet, nga 4 milionë e diçka euro që janë ndarë në infrastrukturë dhe investime kapitale, 1,473,000 euro janë investuar në fshatrat e Gorës. Ajo që është me rëndësi dhe që dua të them, në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, ne kemi pasur sa i përket investimeve kapitale një diskriminim pozitiv. 43.57% të buxhetit për investime kapitale, kjo shifër i përket komunitetit joshumicë.	Uzair Hamza – shef i Zyrës për Komunitete, Komuna e Dragashit	Pranohet	

	Në këto investime kapitale, ka vend për ndryshime të investimeve, në bazë të bisedave me qytetarët e fshatrave;			
5.	1. Mirëmbajtja e rrugëve lokale në Komunën e Dragashit;	Amra Zaimi - gazetare e RTK-së	Pranohet	Mirëmbajtja e rrugëve lokale bëhet me mjetet nga Mallrat dhe Shërbimet, kështu që ne mund të ndajmë mjete të nevojshme për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Ne vitin e kaluar e kemi pas, këtë vit do ta shpallim prapë tenderin për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, deri në dimër. Në dimër pastaj e kemi të rregulluar këtë çështje.

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://www.kllids.gov.net/dragash/news/11/mbajtje-degjimi-buxhetor-me-qytetar-qra-vizite-ny-pensioniste-dhe-komunitete-poshumice/>

Tabela me numrin e pjesëmarrësve sipas përkatësisë gjinore dhe etnike

Nr.	Vendi i mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë			Numri i pjesëmarrësve sipas përkatësisë etnike		
		F	M	T	Shqiptar	Goran/Boshnjak	Të tjerë
1.	Dëgjimi buxhetor me OJQ, biznese dhe fermerë (salla e Asamblesë Komunle)	7	26	33	29	2/2	0
2.	Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë (salla e Asamblesë Komunale)	8	33	41	35	0/5	1 Turk
3.	Dëgjimi buxhetor me qytetarë, gra, vajza, pensionistë, të rinj dhe komunitete joshumicë	4	18	22	19	0/2	1 Amerikane
	Totali:	19	77	96	83	2/9	2

Tabela me numrin e kërkesave dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit Komunal

Nr.	Vendi i mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit Komunal
1.	Dëgjimi buxhetor me OJQ, biznese dhe fermerë (salla e Asamblesë Komunle)	3	1
2.	Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë (salla e Asamblesë Komunale)	2	0
3.	Dëgjimi buxhetor me qytetarë, gra, vajza, pensionistë, të rinj dhe komunitete joshumicë	8	0
	Totali:	13	1

Përgatiti:
Grupi Punues